	Nr. Rendor [1]	Data e kërkesës[2]	Objekti i kërkesës[3]	Data e përgjigjes[4]	Përgjigje[5]	Mënyra e përfundimit të kërkesës[6]	Tarifa[7]
	05	24.08.2026	Kerkesa Nr.2353 Prot., date 24.08.2026 "Informacion mbi procedurat që duhet të ndiqen për kompensim"	02.09.2026	Në përgjigje suajës, të administruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (në vijim ATP) me nr. 2353 prot., datë 24.08.2026, ju bëjmë me dije se: ATP ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, regjistrin e vendimeve të cilat iu kanë njohur subjekteve të shpronësuar të drejtën e kompensimit, si dhe vlerësimet financiare të vendimeve për vitet 1993-2013, ku rezulton se vendimi nr. ****i ish-KKKP, Fier, në emër të subjektit të shpronësuar ****, figuron i publikuar dhe i vlerësuar me vlerë financiare ****** lekë. Përsa më sipër, për përfitimin e kompensimit për vlerën e publikuar përfaqësuesi me prokurë i subjektit të shpronësuar (të të gjithë trashëgimtarëve) mund të aplikoj vetëm on-line, nëpërmjet portalit e-Albania, pasi të këtë plotësuar dokumentacionin konform ligjit nr. 133/2015 dhe VKM-së nr. 313, datë 24.05.2023, e cila ndryshon VKM-në nr.223, datë 23.03.2016. Bashkëlidhur shkresës, dokumentacioni sipas VKM-së nr. 313, datë 24.05.2023.	E plotë	Jo
	06	24.08.2026	Kerkesa Nr.2354. Prot.,, date 24.08.2026 "Kërkesë zyrtare për Informacion, dokumentacion dhe verifikim administrativ lidhur me procedurat e kompensimit.	31.10.2025	Në përgjigje suajës, të administruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (në vijim ATP) me nr. 2354 prot., datë 24.08.2026, ju bëjmë me dije se: Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 7, datë 11.01.2024 "Për shpërblimin e pronarëve dhe për sipërfaqet takuese të pasurive të	E Pjesshme	Jo

					paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", ka miratuar shpërblimin për pasurinë nr.***, zona kadastrale nr. 8120 Tiranë, me sipërfaqe *** m² dhe për pasurinë nr.****, zona kadastrale nr. 8120, Tiranë, me sipërfaqe *** m², që rezulton në emër të bashkëpronarëve *****,*****,*****,*****,. Për sa më sipër, pranë ATP Tiranë, është hapur dosja me nr. ***, dhe ****. Pas verifikimeve të kryera, rezulton se në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 11.01.2024 nuk figuron emri i z. N.S V***. Sa më sipër, ATP nuk mund t'ju vërë në dispozicion të dhëna apo informacione shtesë pasi nuk jeni e legjitimuar (autorizim/prokurë përfaqësimi), nga personat, emrat e të cilëve janë miratuar me VKM-në nr. 7/2024 355 "Për shpërblimin e pronarëve dhe për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale".		

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

[2] Data e regjistrimit të kërkesës

[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

[4] Data e kthimit të përgjigjes

[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

	07	28.08.2026	Kerkesa 2476 Prot., date 28.08.2026 “ Informacion dhe vënie në dispozicion dokumenti”	01.09.2026	Në përgjigje suajës nr. 193, datë 14.08.2026, administruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), me nr. 2476 prot., datë 28.08.2026, ju sqarojmë si më poshtë: Nga verifikimet e kryera në arkivën e ATP-së Tiranë, rezulton se dosja me nr. ***, datë *** në emër të subjektit të shpronësuar **** **** e cila i përket Vendimit nr. **** është sekuestruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me Vendimin e Sekuestrimit datë **** i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me shkresën nr. *** prot.., datë 28.03.2016, administruar në ATP me nr. *** prot., datë 06.04.2017. Gjithashtu ju bëjmë me dije se për të bërë të mundur vënien në dispozicion të kopjes së shkresës dhe vendimit të sekuestrimit, në mbështetje të neneve 44, 45, 65 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative" të Republikës së Shqipërisë, nga ana juaj duhet që kërkesa të jetë e shoqëruar sipas rastit me prokurë përfaqësimi, dëshmi trashëgimie, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për të provuar interesin tuaj të ligjshëm në cilësinë e personit të interesuar në këtë kërkim, i cili duhet të jetë origjinal ose i njësuar me origjinalin. Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen", Ligjit Nr. 43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike",	E Pjeshshme	Jo

					Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 158 Prot., datë 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020", Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 556, datë 17.12.2019 “Për caktimin e personave të autorizuar që do të përdorin Portalin Qeveritar E-Albania për shërbimet online, prej datës 01.01.2020”, ju informojmë se: 1 Për të marrë shërbimin e kërkuar ju duhet të aplikoni në portalin e-albania. "Aplikim për lëshim kopje dokumentacioni". https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service code=14276.		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE